

# KISCOMS

INTERNATIONAL CONGRESS OF MEDICAL SCIENCES

6-7 May, 2017  
Swiss Diamond Hotel  
Prishtina, Republic of Kosovo

## ABSTRACT BOOK FINAL PROGRAM

KISCOMS



## **“Efektet ekonomike në kompanitë si rezultat i menaxhimit korrekt të HACCP - sistemit kontrollues në funksion të sigurisë së ushqimit”**

R. Pejçinovska<sup>1</sup>, Sh. Musa<sup>1</sup>, V. Dobrosavleviq<sup>1</sup>, P. Malinska<sup>1</sup>, P. Simjanoski<sup>1</sup>, L. Kostadinovski<sup>1</sup>, M. Gjetaj-Jakovski<sup>1</sup> / Qendra për Shëndet Publik – Shkup, R. e Maqedonisë

**Hyrje:** Zbatimi i HACCP-sistemit kontrollues luan rol të rëndësishëm për sigurinë shëndetësore të ushqimit, respektivisht pengon helmimin me ushqim tek popullata përmes principeve të përgjithshme për higjienë të ushqimit sikurse: praktika e mirë bujqësore, praktika e mirë higjienike dhe praktika e mirë prodhuese.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij punimi është të prezantohen dhe vlerësohen njohuritë dhe qëndrimet e menaxherëve dhe operatorëve të ushqimit për efektet financiare në kompanitë që janë rezultat i (mos)zbatimit të HACCP sistemit në kompanitë në funksion të sigurisë së ushqimit.

**Materiali dhe metodat:** Si material janë përdorur pyetësorë-anketa prej 197 të anketuarëve në 36 objekte për ushqim në rajonin e qytetit të Shkupit. Është e aplikuar metoda analitiko-statistikore me përdorim të testeve parametrike dhe jo parametrike në nivel me rëndësi statistikore  $p \leq 0.05$ .

**Rezultate:** Analiza statistikore ka dëshmuar dallimin signifikant, sipas testit Pearson Chi-square ( $X^2 = 7.7$   $df = 1$   $p = 0.0055$ ). Të anketuarit mendojnë se kompanija ka fitim financiar me aplikim të HACCP sistemit.

Korelacioni mes kontrollit intern për siguri të ushqimit me kontrollin e higjienës personale ka efekte ekonomike me kompanitë, që i përket implementimit të

standardeve për ushqim të sigurtë ( $p = 0.00006$ ). Njohuritë e menaxherëve për HACCP-sistemin kontrollues ndikojnë konsiderueshëm mbi benefitin ekonomik të kompanisë.

**Përfundim:** Në komunat e rajonit të Shkupit, fituam përgjigje pozitive prej të anketuarëve se i ipet rëndësi sigurisë së ushqimit në shtetin tonë dhe se ekziston benefit ekonomik nga e njëjta përmes respektimit të rregullave ligjore për siguri të ushqimit. Menaxherët më shpesh se operatorët e ushqimit vlerësojnë se implementimi i HACCP sistemit, kompanisë i sjell fitim financiar.

**Fjalë kyçe:** Kompani, fitim, humbje, ushqim, HACCP.

### **“Economic effects in companies as a result of proper management of HACCP control system related to food security”**

R. Pejcinovska<sup>1</sup>, Sh. Musa<sup>1</sup>, V. Dobrosavljevik<sup>1</sup>, P. Malinska<sup>1</sup>, P. Simjanoski<sup>1</sup>, Lj. Kostadinovski<sup>1</sup>, M. Gjetaj-Jakovski<sup>1</sup> / Center for Public Health – Skopje, R. Macedonia

**Introduction:** The application of HACCP control system plays a very important role in the food safety. It prevents food poisoning among the population through general principles of food hygiene, good agricultural practices, good hygiene practices and good manufacturing practice.

**Goal:** The main objective of this paper is to identify the knowledge and attitudes of managers and food operators for financial effects in companies that are the result of (non)implementation of the HACCP system in companies related to safety food.

**Materials and methods:** As a material for the survey are used questionnaires of 197 respondents in 36 food premises in the city of Skopje. A statistical analytical method using parametric non-parametric tests for statistical significance  $p \leq 0.05$ .

**Results:** The statistical analysis has confirmed the significant difference, Pearson Chi-square test ( $X^2 = 7.7$   $df = 1$   $p = 0.0055$ ) in the distribution of respondents who believe that the company has financial benefit by implementing the HACCP system and those who believe that the company has financial losses, depending on how they are implemented written / verbal procedures for

implementing the HACCP system.

The correlation of internal control for food safety with control of personal hygiene has economic effects in the companies, which is due to the implementation of standards for food safety ( $p = 0.00006$ ). The knowledge and experience of managers for HACCP control system significantly affects the company's economic benefit.

**Conclusions:** In the municipalities in the Skopje region, we have received positive response from the respondents that food safety is a topic of significance in Macedonia and that there is an economic benefit from food safety by complying with the legislation on food safety. The managers believe much more than food operators that the implementation of the HACCP system brings financial benefit for the company.

**Key words:** HACCP, Companies, Profit, Loss, Food.